

Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 27.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.08.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “Exim Jatex”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor të QKMF-së dhe QMU-së”, me Nr. të Prok: 616 21 3853 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Exim Jatex”, e datës 25.08.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor të QKMF-së dhe QMU-së”, me Nr. të Prok: 616 21 3853 121 kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 26.08.2021.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “Exim Jatex”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor të QKMF-së dhe QMU-së”, me Nr. të Prok: 616 21 3853 121, me datë 26.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim.

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon:

Të gjitha pretendimet janë të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara nga dosja dhe nga sqarimet plotësuese e që kanë të bëjnë me kualitetin e pjeëve të uniformës-klompeve,sipas te cilave sqarime Autoriteti Kontraktues ka saktësuar se ofertat duhet të dorëzohen sipas kërkesave nga dosja,ndërsa kompetent për verifikimin e cilësisë së mallrave do të jetë komisioni i pranimit;

-Tenderuesi i propozuar pretendon se shenja e shërbimit urgjent është dashte te vendoset ne mostra,por ia përkujtojmë se i njejt i ka kërkuar sqarime se si duhet te duket ajo shenje dhe per kete Autoriteti Kontraktues ka dhene formen si duhet te duket,por në asnjë rast nuk është thënë se ai mbidhkrim duhet të vendoset në mostra.Poashtu tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës ka vendosur çmimin te përshkrimi i pozicionit me të gjitha kërkesat dhe kjo nënkupron se ato do të vendosen me rastin e dorëzimit të artikujëve.Lidhur me këtë ju sqarojmë se ka edhe dy fakte tjera që janë bindëse për furnizimin sipas përshkrimit,pasiqë i njejt i ka dhënë Deklaratën e vet lidhur me specifikimet teknike dhe ka respektuar tekstin e sqarimit në fund të përshkrimit të çmimit për pjesën e parë sipas të cilit për këta dy artikuj me mbishkrim OE-ik ka obligim që para përgatitjes të uniformave të merr masat e të gjithë punëtorëve e të cilat do ta kenë mbishkrimin.

Poashtu tenderuesi i rekomanduar per kontrate ka dorëzuar një Deklaratë të veçantë për ndërrimin e uniformave në çdo rast kur paarqiten nevoja sipas kërkesave të pikave 9.1&9.2 të FDT-së.


Pra nuk ka asnjë element që mund të dyshohet se i rekomanduari për kontratë nuk do ti doërzoj produktet sipas përshkrimit të çmimit dhe rekomandimi është i drejtë dhe i bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.


Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Shtojcë:Kerkesat teknike nga dosja dhe Deklaratat e tenderuesit.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Datë: 19.07.2021

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Lënda: Deklaratë për Specifikacionet Teknike

Të nderuar prokurues të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Ne Arta Tex Group Shpk, përmes kësaj shkrese deklarojmë se:


Mallrat e ofruar për tenderin me titull: "Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor QKMF dhe QMU-së", Pjesa Llot I dhe Llot II, Numri i Prokurimit: 616-21-3853-1-2-1, Numri i Brendshem: 616 21 100 121, përputhen, i përmbushin dhe janë në pajtueshmëri të plotë me të gjitha specifikimet teknike sipas dosjes së tenderit të paraqitura në Aneksi 1 – Specifikacionet teknike të detyrueshme nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit te lartë përmendur

Me Repspekt

Armend Mustafa

Arta Tex Group Sh.p.k

Drejtor



ARTA TEX GROUP Sh.p.k

Adresa: Rr. Faik Konica nr. 17, 30000 Peje



Datë: 19.07.2021

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Lënda: Deklaratë e Ndërrimit të Uniformës

Të nderuar prokurues të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES


Ne **Arta Tex Group Shpk**, përmes kësaj shkrese deklarojmë se:

Për tenderin me titull: "Furnizimi me uniforma për personelin shëndetësor QKMF dhe QMU-së", Pjesa Llot I dhe Llot II, Numri i Prokurimit: 616-21-3853-1-2-1, Numri i Brendshem: 616 21 100 121, nëse kompania e jonë shpallet fituese dhe nënshkruan kontratën për tenderin e sipër përmendur, ne si OE dhe prodhues vendorë do të mundësojmë ndërrimin e uniformes në qfarëdo rasti të mundshëm, sipas përshkrimit në FTD, Neni 9.1 & 9.2, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kerkesa e renditur nr.3

Me Respekt

Armend Mustafa
Arta Tex Group Sh.p.k

Drejtor



Kompanit ofertuese janë të obliguara që të sjellin mostrat(mantil,pantolla,kllompe për të dy gjinitë) së bashku me ofertën.

Kompanit ofertuese janë të obliguara që të sjellin mostrat(mantil,pantolla,kllompe për të dy gjinitë) së bashku me ofertën.

Kompania fituse të mundësoj ndrrimin e uniformës në qfarë do rasti të mundshëm

Deklarat e nënshkruar dhe e vulosur nga OE sedo të mundësoj ndrrimin e uniformës në qfarë do rasti të mundshëm